

## PLANI VJETOR I AKTIVITETEVE

### ARTI DHE KULTURA

#### SHKURT

- \* **11 SHKURT:** Tirana 99 vite kryeqytet
- \* **14 SHKURT:** Tirana Loves

#### MARS

- \* **04 MARS:** Koncert Ermal Meta, pallati i Kongreseve.
- \* **14 MARS:** Dita e Veres.

#### PRILL

- \* **PRILL:** Balkan JAZZ Show Case.

Me pjesëmarrjen e grupeve të muzikës JAZZ nga vendet e Ballkanit.

#### MAJ

- \*5 Maj: Dita e Dëshmorëve
- \* **MAJ:** Festival European i filmit në sheshin Skënderbej dhe në sheshe të ndryshme të Tiranës.

#### DHJETOR

- \* **25 DHJETOR:** Festa e Krishtlindjeve.  
Koncerte për fëmijë e të rritur dhe organizimi i Fshatit të Krishtlindjeve me shtëpizat e drurit.
- \* **31 DHJETOR:** Nata e Vitit të Ri.  
Koncert i madh festiv në Sheshin “Skënderbej” duke pritur momentin e ndërrimit të viteve.

## **TURIZMI DHE TRASHEGIMIA KULTURORE**

### **SHKURT**

\* **11 SHKURT:** Guidë më tematikë: “Tirana 1920”.

Organizohet guidë me tematikë “Tirana 1920” shoqëruar me foto të vjetra. Guida do të realizohet me grupe nxënësish nga shkolla 9-vjeçare të kryeqytetit. Në shkurt të vitit 1920, në Kongresin e Lushnjës, Tirana u vendos të bëhej kryeqyteti i përkohshëm i Shqipërisë.

### **PRILL**

\* **18 PRILL** - Dita ndërkombëtare e Monumenteve dhe Siteve.

Organizim i aktivitetit piknik me lojëra popullore; loja mos u nxehtë në format të madh, loja e shahut në format të madh, etj. Vizitë në rrënojat e Kalasë së Varoshit në Ndroq dhe shijim i pejsazhit mahnitës që ofrohet.

\* **PRILL:** Përrurimi i “Shtëpia Studio Kadare”.

Krijimi i këtij muzeu vendor pikërisht në apartamentin ku ka banuar gjatë viteve të sistemit totalitar shkrimtari Ismail Kadare dhe familja e tij (në vitet 1974 – 1989). Ky muze i shërben përveç tërheqjes të sa më shumë turistëve si dhe zgjatjes së kohë qëndrimit të tyre në Tiranë edhe përmirësimit të imazhit të kryeqytetit dhe promovimit cilësor të tij.

### **MAJ**

\* **22 MAJ:** Dita Ndërkombëtare e Muzeve.

Organizim eventit me nxënës shkollash në “Shtëpia Studio Kadare” me guidë tematike. Fillon me guidën tematike të shkrimtarëve shqiptarë: Petro Marko, Dritëro Agolli dhe Ismail Kadare dhe përfundon në muzeun e sapo hapur Kadare.

### **KORRIK**

\* **12 KORRIK:** Festa e fërgesës.

Festë lokale tradicionale e organizuar me gatime tironce ku kryeson fërgesa tradicionale. Aktiviteti do të zhvillohet në një nga restorantet tradicionale në Ceren (Dajt).

### **GUSHT**

\* **2 GUSHT** – Liqeni i Farkës.

Stand up Paddle në liqenin e Farkës në bashkëpunim me Albania Adventure.

### **SHTATOR**

\* **8 SHTATOR:** Festa e Verës në Shesh.

Kjo festë lokale e kthyer në traditë do mbledhë bashkë prodhuesit dhe pijedashësit e verës. Kultivimi i vreshtave dhe prodhimi verës në këtë zonë tashmë është kthyer në një traditë e cila identifikon atë. Aktiviteti do të zhvillohet në një ambient rrethuar nga gjelbërimi dhe vreshtat e rrushit, në të cilin do të ngrihet një mini-panair me produktet e zonës të kilometrit zero.

**\* 22 SHTATOR: Domate Fest.**

Festa lokale fillon që me udhëtimin për në Shën Gjergj, një destinacion që të lë pa frymë për panoramën që ofron dhe që është lehtësisht i arritshëm. Eventi do jetë i shoqëruar me panair produktesh tipike dhe gatime tradicionale të zonës, pjata me bazë domaten, koncerte me muzikë popullore, guida në atraksione historike e natyrore, degustim produktesh, etj.

**\* 27 SHTATOR – Dita Botërore e Turizmit.**

**“Tourism and the Digital Transformation”** - *slogani* i vendosur nga Organizata Botërore e Turizmit për vitin 2019. Në këtë ditë do projektohen pamje të Tiranës ndër vite në ekran Led te sheshi pranë Kullës së Sahatit dhe muzeut.

**\* 29 SHTATOR – Petrelë: Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore.**

Organizohet eventi “Muzeu lëvizës” por edhe itinerare në site arkeologjike ( Petrelë,Dorëz, etj).

## **TETOR**

**\* 18 TETOR: Guidë tematike: “Figura e Nënë Terezës”.**

Organizohet guidë me tematikë mbi jetën dhe veprën e Nënë Terezës te sheshi “Nënë Tereza”, shtëpia e motrave të Nënë Terezës dhe shtëpia ku kanë jetuar nëna dhe motra e saj.

## **NËNTOR**

**\* 3 NËNTOR: Festa e Ullirit.**

Organizohet një panair me produkte lokale dhe një vizitë në ullinjtë shumëshekullorë të Brarit. Prezantim i shkurtër i ullinjve shekullorë nga ekspertë të fushës. Guidë në atraksionet e zonës : Ura e Brarit – monument Kulture dhe për të apasionuarit pas natyrës dhe aventurës ecje te kanionet e Brarit (lumi i Tiranës).

**\* 17 NËNTOR: Guidë tematike: “Dita e çlirimit të Tiranës”.**

Në këtë ditë organizohen guida me nxënësit e shkollave të kryeqytetit në vendet me histori nga LANÇ.

**\* 26 NËNTOR: Guidë tematike: “Shpallja e Pavarësisë”.**

Evente përkujtimore, guida me nxënës të shkollave 9 vjeçare të kryeqytetit, etj.

\* **29 NËNTOR:** Nata e Bardhë.

Organizohet festë rinore dhe koncert me muzikë kontemporane në Sheshin “Skënderbe” me këngëtarët më të mirë vendas dhe të huaj.

## **DREJTORIA E POLITIKAVE DHE EDUKIMIT MJEDISOR**

### **SHKURT**

- \* **SHKURT-MAJ:** Ore edukative me shkollat 9-vjeçare të Tiranës
- \* **SHKURT-DHJETOR:** Takime informuese me komunitetin lidhur me pastrimin e qytetit.

### **MARS**

- \* **30 MARS:** Ora e Tokës.
- \* **MARS-TETOR:** Prezantimi i kodit rrugor dhe rregullave të trafikut për çiklistët sipas planit të punës për zbatimin e Planit të Veprimit Qytet i Gjellbër për Tiranën (GCAP), me urdhër të Kryetarit Nr. 45178, datë 06.12.2018

### **PRILL**

- \* **22 PRILL:** Dita Ndërkombëtare të Tokës.

Aktivitete te ndryshme mjedisore.

### **QERSHOR**

- \* **1-5 QERSHOR:** “Java e Mjedisit” (Aktivitete për disa ditë me radhë në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit, 5 qershor)

### **SHTATOR**

- \* **16-22 SHTATOR** “Java Europiane e Levizshmërisë”, zhvillimi i aktiviteteve lidhur me promovimin e transportit ekologjik.

### **TETOR**

- \* **TETOR-DHJETOR:** Ore edukative me shkollat 9-vjeçare të Tiranës.

### **DHJETOR**

- \* **DHJETOR:** Fushata e pyllëzimit të Tiranës, mbjellje lulesh dhe bimësh dekorative

## **DREJTORIA E RINISE**

### **SHKURT**

\* **SHKURT-MAJ:** Tirana Art Fest 4.

Gjallërimi i jetës kulturore- artistike si edhe nxitja, promovimi i talenteve të reja dhe inkurajimi i krijuesve të rinj të shkollave të mesme.

\* **SHKURT-MAJ:** Cdo të premte të parë të muajit.

Bashkia në një Ditë. Takime me nxënës të gjimnazeve të qytetit të Tiranës dhe rrethinave për të parë sesi zhvillohet 1 ditë pune në BT.

\* **SHKURT:** “Public Speaking&stand up comedy”.

Zhvillim i të folurit tek të rinjtë.

\* **SHKURT-MAJ:** Ngritja e grupeve të leximit në çdo shkollë. Diskutime mbi librat dhe autor të ndryshëm. Gjimnaze të Tiranës dhe shkolla 9 – vjeçare.

**SHKURT-DHJETOR:** Vullnetarizmi. Aktivitete të ndryshme për promovimin e vullnetarizmit. Promovimi i ditës ndërkombëtare të vullnetarizmit.

\* **SHKURT-DHJETOR:** Takim për Librin. 1 ditë në muaj sipas kalendarit të bibliotekave. Diskutim për librin dhe nxitja e lexuesve të rinj.

\* **SHKURT-DHJETOR:** Lexim i librave për fëmijë në bibliotekat e lagjeve. Lexim i një libri për fëmijë nga vullnetarë. 1 ditë në muaj sipas kalendarit të bibliotekave.

\* **SHKURT-DHJETOR:** Dhuroji Tiranës një libër. Promovimi i dhurimeve të librave nga individë apo grupe te ndryshe për nxitjen e dhurime në biblioteka.

\* **SHKURT-DHJETOR:** Vizitë në Bashkinë e Tiranës. Staf i Bashkisë Tiranë, Rezidencat Studentore-studenë të cilët nisin studimet e tyre për herë të parë në qytetin e Tiranës.

\* **SHKURT-DHJETOR:** Multi language coffee. Njohja dhe zhvillimi i gjuhëve të huaja në nivel fillestar në një nga Bibliotekat e Lagjeve.

## MARS

\* **21 MARS:** Dita Botërore e Poezisë.  
Aktivitet të organizuara nga Bibliotekat e lagjeve për ditën botërore të poezisë.

\* **MARS- QERSHOR:** Konkurs i ideve rinore vetem për studentet.

Hapet Thirrja për ide të reja inovative që lidhen me Bashkinë Tirane propozim nga studentët dhe 3 idetë më të mira financohen nga BT.

\* **MARS- QERSHOR:** Festivali letrar në poezi dhe ese.

Konkurs midis të rinjve mbi krijimet e tyre në një nga tre zhanerat që ofron ky festival letrar.

\* **MARS- QERSHOR:** Projektit i Debatit.  
Zhvillimi i mendimit kritik, formati Karl Popper ose IDEA me studentët.

## PRILL

\* **23 PRILL:** Dita Botërore e Librit.

Aktivitete të ndryshme të organizuara nga Bibliotekat e lagjeve për ditën botërore të librit. Shpallja e lexuesit më të mirë.

## MAJ

\* **MAJ:** Youth Camp me të rinjtë.

## KORRIK

\* **KORRIK:** Shkëmbime Rinore- Youth Trail.

Shkëmbim eksperiencash me të rinj të tjerë në capacity building.

## SHTATOR

\* **SHTATOR:** Informacion mbi Erasmus+.

Info session mbi mundësitë e programit Erasmus+ dhe programeve të tjera për të rinjtë që ofrojnë komisioni European dhe Korpusi i Solidaritetit.

## DHJETOR

\* **8 DHJETOR:** Dita e Rinisë. Aktivitet për Ditën e Rinisë

## **DREJTORIA E SPORTEVE PROFESIONALE DHE KOMUNITARE**

### **SHKURT**

\* **SHKURT- MAJ:** Kampionati i mini kalctos për Djem.

Promovimi i sportit të futbollit në shkollat 9-vjecare, angazhimi i të rinjve me aktivitet sportiv si dhe nxitja e konkurences së shëndetshme sportive midis shkollave.

### **MARS**

\* **MARS-MAJ:** Lojrat Popullore “Kthim në Traditë”.

Lojrat Popullore Sipas Krahinave “Kthim në Traditë”do të zhvillohet me shkollat publike 9-vjeçare të Tiranës. Misioni i këtij projekti është të zhvillojë dhe promovojë sportet në natyrë duke qënë se fëmijët janë shumë pak të ekspozuar me natyrën dhe kjo ndikon negativisht në rritjen e tyre. Nëpërmjet lojës fëmija, rritet zhvillohet. Grup-moshat që do të përfshihen në këtë aktivitet do të jenë nga mosha 9 deri në 15 vjeç.

\* **MARS:** Kids Athletics.

Drejtorja e Sporteve Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Federatën e Atletikes do të organizojë aktivitetin sportiv Kids Athletics me nxënësit e shkollava 9-vjecare. Ky aktivitet ka për qëllim:

- Promovimin dhe masivizimin e sportit të atletikës.
- Aftësimin fizik, shkathtësimin e femijëve.
- Evidentimin e talenteve të reja në sportin e atletikës.

\* **MARS- QERSHOR:** Kampionati i mini kalctos për Vajza.

Promovimi i sporteve të ndryshme në shkollat 9-vjecare dhe të mesme, angazhimi i të rinjve me aktivitet sportiv si dhe nxitja e konkurencës së shëndetshme sportive midis shkollave.

\* **MARS- QERSHOR:** Kampionati i Basketbollit për Djem.

Promovimi i sporteve të ndryshme në shkollat 9-vjecare dhe të mesme, angazhimi i të rinjve me aktivitet sportiv si dhe nxitja e konkurences së shëndetshme sportive midis shkollave.

\* **MARS-QERSHOR:** Kampionati i Basketbollit për Vajza.

Promovimi i sporteve të ndryshme në shkollat 9-vjecare dhe të mesme, angazhimi i të rinjve me aktivitet sportiv si dhe nxitja e konkurences së shëndetshme sportive midis shkollave.

\* **MARS-QERSHOR:** Kampionati i volejbollit për Vajza.

Promovimi i sporteve të ndryshme në shkollat 9-vjecare dhe te mesme, angazhimi i të rinjve me aktivitet sportiv si dhe nxitja e konkurences së shëndetshme sportive midis shkollave.



## **QERSHOR**

\* **QERSHOR:** Tirana Triathlon. Edicioni i dytë i Tirana Triathlon.

Projekti "Tirana Triathlon" ka për qëllim të promovojë disiplina të ndryshme sportive, aktivitete fizike, masivizimin e eventeve outdoor, si dhe promovimin e atraksioneve turistike.

Kjo garë jo vetëm që bashkon në konkurim sportistë të ndryshëm, por jep mundësinë e promovimit të zonës së Farkës e cila mbart në vetvete vlera turistike .

\* **QERSHOR:** Kids Athletics.

Drejtoria e Sporteve Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Federatën e Atletikes do të organizojë aktivitetin sportiv Kids Athletics me nxënësit e shkollave 9-vjecare. Ky aktivitet ka për qëllim:

- Promovimin dhe masivizimin e sportit të atletikës.
- Aftësimin fizik, shkathtësimin e fëmijëve.
- Evidentimin e talenteve të reja në sportin e atletikës.

## **TETOR**

\* **13 TETOR:** Maratona e Tiranës

\* **TETOR- DHJETOR:** Kampionate të ndryshme sportive midis njësive Administrative. Në kuadër të projektit Shkolla Qender Komunitare do të zhvillohen kampionate në sporte të ndryshme midis shoqatave fituese sipas njësive administrative. Qëllimi kryesor i këtij projekti është angazhimi i të rinjve me aktivitet fizik dhe vënia në lëvizje e projektit.